



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:015334
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478075

C-IV-14-6145

Sh M, nga Prizreni

Ankuesja

Përfaqësuar av. O R, Prizren

kundër

E paditura

**Agjencia Kosovare e Privatizimit për NSH KBI “Progres Export” “Lavërtaria- Blegtoria”
Prizren (në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 20 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Ankuesja i bartë shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 gusht 2014, ankuesja parashtrij ankesë kundër Njoftimit të Organit të Likuidimit pranë AKP-së me numër protokolli 27512 të datës 16.07.2014, me të cilin është iniciuar procedura e likuidimit të N.SH KBI “Progres Export” “Lavërtaria-Blegtoria”.

Me 20 shkurt 2024, gjykata lëshoj për ankuesen urdhër për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesen se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ankuesja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 20 shkurt 2024, Gjykata përmes urdhrit kërkoj nga ankuesja, që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankueses i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesja ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga ankuesja me datë 26.02.2024, mirëpo ajo nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesja nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), ankuesja si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare